



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. _____, Datë ___/___/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 143, datë 01.11.2017, e Znj. M.V., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “gjuhës”, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se në datën 17.10.2017, në faqen www.unishk.edu.al, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër ka bërë shpalljen publike për një vend të lirë punë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Departamentit të Psikologjisë dhe Punës Sociale, për pozicionin as/lektor/e me kohë të plotë për lëndët “Psikologji ligjore” dhe “Psikologji shëndeti”, në programet e studimit bachelor në “Psikologji” dhe “Punë Sociale”.

Ankuesja sqaron se në kriteret e vendosura për këtë vend pune, njëri prej tyre krijon dy standarde, duke passjellë pabarazi dhe diskriminim të hapur në konkurs, nëpërmjet atyre që kanë kryer studimet e larta në sistemet e dikurshme 4-vjeçare dhe disponojnë Diplomë të Nivelit të

Dytë (DND), në raport me të diplomuarit që kanë përfunduar “Master Shkencor” sipas sistemit të ri të studimeve. Kriteri në fjalë, sipas ankueses është kriteri i notës mesatare, të cilin e konsideron si kriter përjashtues.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 143, datë 01.11.2017, e Znj. M.V., Komisioneri konstatoi se nga pikëpamja formale, ankesa nuk plotëson kërkesat e parashikuara ligjore.

Në nenin 33, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohen kriteret formale, që duhet të plotësojë një ankesë e depozituar pranë Komisionerit. Nga verifikimi i kryer në formularin e ankesës së Znj. M.V., Komisioneri konstatoi se rubrikat përkatëse, ku duhet të shënoheshin adresa dhe numri i telefonit të ankueses, rezultojnë të paplotësuara. Në formular është shënuar vetëm një adresë e-maili. Gjithashtu, ankuesja nuk ka plotësuar edhe rubrikat 5-8 të formularit të ankesës, që kanë të bëjnë me faktin, nëse e njëjta çështje po shqyrtohet në kuadër të një ankesë tjetër apo nëse për të është marrë një vendim i mëparshëm; mbi dhënien e informacionit, lidhur me kohën e ndodhjes së diskriminimit; momentin e marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar; dhe numrin e dokumentave që shoqërojnë ankesën.

Në datën 07.11.2017, strukturat përgjegjëse të Komisionerit iu drejtuan me e-mail ankueses, ku iu kërkua dërgimi i informacionit përkatës, lidhur me rubrikat e paplotësuara, si informacione të tjera shtesë mbi diskriminimin e pretenduar nga ana e saj. E-maili i dërguar u kthyer mbrapsht, me shënimin se adresa e e-mailit të ankueses nuk është e disponueshme.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se ankesa nr. 143, datë 01.11.2017, e Znj. M.V. nuk plotëson kriteret formale, që duhet të përmbushë një ankesë e depozituar pranë Komisionerit, përkatësisht kriterin e përcaktuar në nenin 33, pika 3, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku përcaktohet se ankesa duhet të përmbajë “shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 3, gërma b) të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Mospranim të ankesës nr. 143, datë 01.11.2017, e Znj. M.V., pasi nuk plotëson kriteret formale, që duhet të plotësojnë ankesat që depozitohen pranë Komisionerit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak - gjuha

